REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR

REGJISTRIN ELEKTRONIK TË DËMEVE TË SIGURIMEVE TË DETYRUESHME MOTORIKE

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 249, datë 24.12.2019

Neni 1

Objekti

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave për raportimin elektronik të të dhënave të dëmeve të sigurimeve të detyrueshme motorike, sipas nenit 2, pika 1) germa b), të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, në Regjistrin Elektronik të Dëmeve, të instaluar në Qendrën e Informacionit pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore miratohet në bazë dhe për zbatim të nenit 38 të Ligjit nr.10076, datë 12.02.2009 "Për Sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" dhe të nenit 14 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare".

Neni 3

Fusha e veprimit

Shoqëria e sigurimit dhe Byroja detyrohen të furnizojnë regjistrin e dëmeve me të gjitha të dhënat për dëmet që rrjedhin nga sigurimi i përgjegjësisë së pronarit ose përdoruesit të mjetit motorik, për dëme shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.

Neni 4

Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a. "Autoritet" nënkupton Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare;
b. "Byroja" nënkupton Byronë Shqiptare të Sigurimeve;
c. "Shoqëri sigurimi" nënkupton shoqërinë e sigurimit, e cila është e licencuar për të ushtruar veprimtari në klasat që lidhen me sigurimin e detyrueshëm motorik;
d. "Qendra" nënkupton "Qendrën e informacionit të sigurimeve të detyrueshme", krijuar në bazë të Ligjit nr.10076, datë 2.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit";
e. "Regjistri Elektronik i Dëmeve" nënkupton programin kompjuterik, i cili realizon regjistrimin elektronik të dëmeve të sigurimeve të detyrueshme motorike i instaluar në serverat e Qendrës.

Neni 5

Detyrimi për të dhënë informacion

1. Shoqëria e sigurimit dhe Byroja, janë përgjegjëse për dhënien e të gjithë informacionit pranë Qendrës për regjistrin e dëmeve, sipas formës së përcaktuar nga kjo rregullore.
2. Shoqëria e sigurimit dhe Byroja raportojnë në Regjistrin Elektronik të Dëmeve, të dhënat sipas Aneksit 1 dhe Aneksit 2 të kësaj rregulloreje në kohë reale, për çdo dosje dëmi të hapur prej tyre.
3. Për çdo veprim apo ndryshim të informacioneve të dosjes të dëmit, shoqëria e sigurimit dhe Byroja raportojnë pranë Regjistrit Elektronik të Dëmeve në kohë reale.
4. Në raste të gabimeve gjatë raportimeve të bëra pranë Regjistrit Elektronik të Dëmeve, shoqëria e sigurimit dhe Byroja duhet t'i korrigjojë menjëherë ato dhe të bëjnë raportimin e saktë në kohë reale ose të njoftojnë Autoritetin për çdo problematikë me ndryshimet e dosjeve të dëmit.
5. Shoqëria e sigurimit dhe Byroja caktojnë punonjësit, të cilët janë përgjegjës për raportimin e të dhënave për dëmet pranë Regjistrit Elektronik të Dëmeve dhe duhet të njoftojnë menjëherë Autoritetin për çdo ndryshim të tyre.
6. Dosja e një dëmi është e vetme pavarësisht nga historiku i saj. Në veçanti dosja, e cila bëhet pjesë e një procesi gjyqësor do të jetë vazhdim i shqyrtimit të dosjes ekzistuese të dëmit dhe jo të hapet një ngjarje/dosje e re.
7. Shoqëria e sigurimit është e detyruar të pajisë palën e dëmtuar me numrin unik të AMF-së, të gjeneruar automatikisht nga sistemi në momentin e regjistrimit të dosjes në Regjistrin Elektronik të Dëmeve. Numri unik, si dhe udhëzimet për palën e dëmtuar që nëpërmjet këtij numri unik mund të ndjekë ecurinë e trajtimit të dosjes së tij në faqen e Autoritetit, evidentohen në kopjen e formularit të kërkesës për dëmshpërblim që i jepet kërkuesit të dëmshpërblimit.

Neni 6

Mënyra e raportimit të dosjeve të dëmit

1. Në Regjistrin Elektronik të Dëmeve duhet të raportohen nga ana e shoqërive të sigurimit të gjithë dosjet, që rrjedhin nga detyrimet e tyre për policat e sigurimit të detyrueshëm motorik.
2. Regjistri Elektronik i Dëmeve mund të aksesohet nëpërmjet linkut: https://claims.amf.gov.al/claims , i cili përshtatet me të gjitha tipet e browser-ve, ose edhe nëpërmjet web serviseve ne linkun https://claims-ws.amf.gov.al:30443/api/v1
3. Shoqëria e sigurimit dhe Byroja duhet të marrin të gjitha masat për të përshtatur sistemet informatike respektive të raportimit të dëmeve, për të operuar në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje.
4. Një dosje dëmi do të raportohet sipas hierarkisë Ngjarje – Dosje Dëmi për Përfitues, ku:
    - Ngjarja - është ndodhia e aksidentit (me të dhënat e sakta të datës dhe vendndodhjes) së bashku me shkaktarin e ngjarjes me të dhënat e gjeneralitetet e tij, policës dhe mjetit të shkaktarit;
    - Dosje Dëmi për Përfitues - është dosja që hapet për çdo përfitues më vete brenda të njëjtës ngjarje. Dosjet e demit kanë të dhënat e vlerave të përllogaritur /rivlerësuar /gjyqësore të dosjes, statusin e saj, të dhënat gjenerale të përfituesit, si dhe pagesat përkatëse;
    - Çdo dosje dëmi me përfituesit përkatës identifikohet me një kod unik AMF, të gjeneruar automatikisht nga sistemi.
5. Çdo ngjarje duhet te jete e raportuar vetëm njëherë nga përdoruesit e autorizuar te shoqërive dhe ne rast përfituesi të ri duhet të hapet një dosje në po këtë ngjarje, e cila identifikohet me një kod unik të ri nga Regjistri Elektronik i Dëmeve.
6. Për çdo lloji dëmi që i përkasin të njëjtit përfitues, në varësi të dokumentacionit dhe afateve të trajtimit, hapet dosje e veçanta brenda të njëjtës ngjarje si me poshtë:
    a. Dëm pasuror material;
    b. Dëm pasuror shëndetësor;
    c. Dëm jo pasuror.
7. Regjistrin Elektronik i Dëmeve është i ndërlidhur në kohë reale me Regjistrin Elektronik Online te Sigurimit te Detyrueshëm Motorik të policave të sigurimit të detyrueshëm dhe për rastet kur shkaktari është i siguruar atëherë, nëpërmjet kodit unik te policës do te plotësohen automatikisht te gjithë te dhënat e mjetit dhe polices dhe të të siguruarit.
8. Në Regjistrin Elektronik të Dëmeve duhet të raportohet shkaktari real i ngjarjes dhe jo domosdoshmërish pronari apo përdoruesi i mjetit në policë. Gjithashtu edhe për rastet e shkaktareve ku mjeti është në pronësi të një subjekti, tek të dhënat e shkaktarit duhet te vendoset përdoruesi i mjetit ne momentin e aksidentit dhe jo subjekti pronar. Në bazën e të dhënave të regjistrit ruhen automatikisht edhe të dhënat e pronarit të mjetit si pjesë e sistemit Bonus-Malus.
9. Çdo praktikë dëmi e regjistruar në Regjistrin Elektronik të Dëmeve për dëmet e ndodhura, pavarësisht statusit të praktikës duhet të ketë një vlerësim nga shoqëria e sigurimit (vlera e demit e përllogaritur). Për praktikat e dëmeve për të cilat shoqëria e sigurimit ka mungesë dokumentacioni në vlerësimin e plotë të vlerës së dëmit, në varësi të llojit të dëmit, në bazën e të dhënave të dëmeve duhet të mbaj një vlerë dëmi sipas Rregullores nr. 9, datë 25.01.2016 "Mbi bazat dhe metodat e llogaritjes, mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike, si dhe

kriteret dhe procedurat e miratimit të tyre nga Autoriteti"

10. Në momenti që një dosje dëmi paguhet plotësisht dhe vlera e mbetur behet zero, atëherë dosja kalon automatikisht ne statusin PAGUAR dhe e gjithë ngjarja bëhet e pa ndryshueshme. Në rast se kjo dosje do të kërkohet të rihapet, shoqëritë e sigurimeve apo Byroja duhet të njoftojnë Autoritetin me email në adresat e suportit : support@amf.gov.al për të rihapur dosjen, duke evidentuar edhe arsyen e rihapjes. AMF ndjek procedurën për rihapjen e dosjes së kërkuar.
11. Në plotësimin e dosjes për çdo përfitues duhet të evidentohet vetë personi i dëmtuar /përfituesi dhe jo përfaqësuesit e tij.

Neni 7

Mënyra e raportimit në raste të veçanta

1. Dosjet e Fondit të Kompensimit duhet të raportohen në Regjistrin Elektronik të Dëmeve nga ana e Byrosë Shqiptare të Sigurimeve në momentin që pala e dëmtuar paraqitet pranë tyre. Pas raportimit, Byroja ketë dosje ja kalon shoqërive të sigurimeve për trajtim dhe ndjekjen e mëtejshme.
2. Shoqëritë e sigurimeve duhet të trajtojnë dhe ndjekin praktikën e Fondit të Kompensimit që Byroja ja ka kaluar secilës prej tyre duke bërë ndryshimet në Regjistrin Elektronik të Dëmeve, njësoj si edhe praktikat e tjera për TPL.
3. Në rastet kur shkaktar i një dëmi është një mjet i përbërë nga mjeti tërheqës (koka), apo mjeti i tërhequr (rimorkio) dhe të dyja këto të fundit janë siguruar në shoqëri sigurimi të ndryshme, raportimi bëhet nga ajo shoqëri ku është hapur dosja e dëmit, pas paraqitjes së kërkesës nga pala e dëmtuar. Në raportim jepen të gjitha të dhënat për të dy mjetet.
4. Në rastet kur shkaktari i një dëmi, apo shoqëria e sigurimit përgjegjëse identifikohet më vonë, pasi është trajtuar fillimisht prej shoqërive te sigurimit si fondi i kompensimit, për shkak se mjeti shkaktar ka qenë i paidentifikuar, me kalimin e dosjes shoqërisë së mjetit shkaktar të dëmit, kjo e fundit duhet ta raportojë atë pranë Regjistrit Elektronik të Dëmeve, duke ndryshuar statusin "Dërguar Shoqërisë së Identifikuar dhe duke përzgjedhur shoqërinë e mjetit shkaktar. Ndërkohë në rast se një dosje e tillë është trajtuar nga Byroja duhet të bëjë ndryshimin e statusit "I identifikuar". Për të dyja këto raste shoqëritë e sigurimit apo Byroja duhet të njoftojnë Autoritetin me email në adresën e suportit.
5. Në rastet kur një palë e dëmtuar nga një mjet motorik i pasiguruar ose i paidentifikuar (rast që trajtohet nga fondi kompensimit), paraqitet drejtpërdrejt në një shoqëri sigurimi, kjo e fundit pasi hap praktikën e dëmit, të kompletuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar ligjor, bën raportimin e kësaj praktike dëmi në Regjistrin Elektronik të Dëmeve, si për të gjitha rastet e tjera të dëmeve të sigurimit të detyrueshëm motorik, duke plotësuar të gjitha të dhënat e përcaktuara në aneksin 1 dhe 2 kësaj të rregullores.
6. Kur kemi të bëjmë me një mjet të pa siguruar, raste të dëmeve që trajtohen nga fondi i kompensimit, të dhënat për policën e sigurimit do jenë të paplotësuara. Ndërsa në lidhje me të dhënat e mjetit do të plotësohen nga përdoruesit e regjistrit me informacionet që ata kanë.
7. Kur kemi të bëjmë me një mjet të paidentifikuar, raste të dëmeve që trajtohen nga fondi i kompensimit, të dhënat për shkaktarin dhe policën e sigurimit të automjetit shkaktar të dëmit do të jenë të paplotësuara.

8. Praktikat e dëmeve të kartonit jeshil, do të regjistrohen nga çdo shoqëri në Regjistrin Elektronik të Dëmeve, brenda 24 orëve nga momenti i hapjes së një dosje të re nga struktura e kartonit jeshil të shoqërisë, pas marrjes së njoftimit të rastit të sigurimit nga korrespondentët apo Byroja e vendit të ndodhjes së aksidentit.
9. Të dhënat që do të regjistrohen në rastet e praktikave të dëmeve të kartonit jeshil do të jenë të njëjta me ato të dëmeve të TPL, me ndryshimin e vetëm që në vend të numrit të raportit të policisë që kërkohet në rastet e dëmeve TPL, do të vendoset numri i referencës së vendosur nga korrespondenti apo byroja e vendit të ndodhjes së aksidentit dhe tek shënimet e ngjarjes do të vendoset emri i korrespondentit apo byrosë së vendit nga ka ardhur njoftimi i rastit të sigurimit.
   Statusi i këtyre praktikave do të ndryshohet sipas çdo ndryshimi që do të ndodhë gjatë trajtimit të tyre nga struktura e kartonit jeshil të shoqërisë.

Neni 8

Kostoja e regjistrit të dëmeve

1. Projektimi i Regjistrit Elektronik të dëmeve bëhet duke shfrytëzuar infrastrukturën hardware dhe licencimin software të krijuar gjatë ngritjes së regjistrit të shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik si pjesë përbërëse e Qendrës.
2. Kosto e projektimit të ndryshimeve sipas nevojave dhe mirëmbajtjes së sistemit, përballohen nga shoqëria e sigurimit në pjesë të barabarta.

Neni 9

Specifikimet Teknike

1. Programi kompjuterik i Regjistrit Elektronik të Dëmeve, skemat e detajuara dhe karakteristikat e procesit të identifikimit dhe raportimit të dëmeve janë paraqitur në Aneksin 1, bashkëngjitur.
2. Web Services i Regjistrit Elektronik të Dëmeve, duhet të ketë karakteristikat e renditura në Aneksin 2, bashkëngjitur.

Neni 10

Aksesi i informacionit

1. Autoriteti përcakton përdoruesit e autorizuar të shoqërisë së sigurimit dhe Byrosë të cilëve iu jepet akses në ndërfaqen e Regjistrit Elektronik të Dëmeve apo edhe në web servicen për të raportuar ose përdorur të dhënat në përkatësi të regjistrit të dëmeve me qëllim përmbushjen e nevojave të tyre, duke përcaktuar nivelin e informacionit në të cilën ato mund të kenë akses si dhe formën e këtij aksesi.

2. Autoriteti mund t'u japë akses në regjistër përdoruesve të autorizuar sipas marrëveshjeve dypalëshe.

3. Përdoruesit e autorizuar detyrohen të zbatojnë parashikimet e rregullores "Për konfidencialitetin në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" miratuar me Vendimin e Bordit nr.114, datë 11.09.2008, ndryshuar.

Neni 11

Përgjegjësitë për mirëmbajtjen e regjistrit të dëmeve

1. Autoriteti është përgjegjës për funksionimin e plotë të Regjistrit Elektronik të Dëmeve në cilësinë e administratorit të Qendrës.
2. Shoqëria e sigurimit dhe Byroja janë përgjegjëse për komunikimin e nevojshëm me/dhe midis pjesëve përbërëse të regjistrit të dëmeve.
3. Ruajtja fizike dhe elektronike e të dhënave të regjistrit të dëmeve kryhet nga personeli i autorizuar i Autoritetit.
4. Mbështetja operacionale e programeve kryhet nga personeli i autorizuar nga Autoriteti, të mbështetur nga specialistë të jashtëm, bazuar sipas kontratës së mirëmbajtjes.
5. Regjistri i dëmeve të sigurimit të detyrueshëm motorik vepron pa ndërprerje gjatë gjithë javës dhe 24 orëve të ditës.
6. Suporti ndaj përdoruesve të regjistrit të dëmeve jepet përgjatë orarit zyrtar të administratorit të Qendrës. Adresa email: support@amf.gov.al

Neni 12

Sanksione

Çdo mos evidentim i të dhënave për dëmet në regjistrin e dëmeve, si dhe çdo veprim që bie në kundërshtim me përcaktimet e kësaj rregulloreje, është objekt i sanksioneve të parashikuara në nenin 52, të Ligjit nr.10076, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", i ndryshuar, si dhe neneve 31 dhe 32 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar.

Neni 13

Dispozita kalimtare

1. Shoqëritë e sigurimit dhe Byroja, janë përgjegjëse për furnizimin e Qendrës me të gjithë informacionin historik të dosjeve të dëmeve pa paguara (pezull) në datë 31.12.2017, sipas formës së përcaktuar nga kjo rregullore.
2. Shoqëria e sigurimit dhe Byroja raportojnë në Qendër sipas Anekseve 1 dhe 2, të kësaj rregulloreje, çdo ngjarje apo dosje të re, si dhe informacionin e cilësuar në pikën 1 të këtij

neni, brenda datës 31.01.2020.

3. Deri sa Regjistri Elektronik i Dëmeve të përshtatet sipas nenit 7, pika 1 dhe 2 e kësaj rregulloreje, të gjithë dosjet e Fondit të Kompensimi me datë aksidenti 01.01.2014 e në vijim, duhet të raportohen nga ana e shoqërive të sigurimit, ndërsa dosjet e Fondit të Kompensimit me datë aksidenti deri më 31.12.2013 duhet të raportohen dhe ndiqen nga Byroja Shqiptare e Sigurimeve.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 janar 2020.

ANEKSI 1

Manual Përdorimi
Regjistri Elektronik i Dëmeve

Versioni	Data	Ndryshime nga	Arsye	Autori
V.1.1	13.09.2017	AMF	Shoqëritë e Sigurimit do të regjistrojnë edhe dosjet FK	Drejtoria TI
V.1.2	10.11.2017	AMF	Shtimi i statusit MBYLLUR	Drejtoria TI
v.2.0	01.01.2020	AMF	Shtime funksionalitetesh dhe rishikimi i Rregullores nr. 36	Drejtoria TI

Përmbajtja

HYRJA NË SISTEM 9

1. FAQJA E PARË 10

1.1. Funksionalitetet e Faqes së parë 10

2. NGJARJE E RE 11

2.1. Dosje e re 17

2.2. Shto Pagesë Dëmi 21

3. KËRKO NGJARJE 24

4. KËRKO DOSJE DËMI 24

5. KËRKO SHKAKTAR DËMI 25

6. DOSJE PËR SHQYRTIM 25

7. KËRKO PËRFITUES 26

8. KËRKO DOSJE TË PAGUARA 27

HYRJA NË SISTEM

Regjistri Elektronik i Dëmeve mund të aksesohet nëpërmjet linkut:
https://claims.amf.gov.al/claims i cili përshtatet me të gjitha tipet e browser-ve.

Do të shfaqet faqja për tu plotësuar me përdorues, fjalëkalim dhe tokën.



1. FAQJA E PARË

Pasi të jetë kryer hyrja në sistem do të shfaqet faqja e parë, e cila përmban këto menu kryesore:



- FAQJA E PARË
- NGJARJE E RE
- KËRKO NGJARJE
- KËRKO DOSJE DËMI
- KËRKO SHKAKTAR DËMI
- DOSJE PËR SHQYRTIM
- KËRKO PËRFITUES
- DOSJE TË PAGUARA

Le ti marrim me radhë të gjitha menutë kryesore duke shpjeguar sipas dhe rendit të mësipërm

1.1. Funksionalitetet e Faqes së Parë

- Informacion për përdoruesin dhe shoqërinë përkatëse.
- Raport përmbledhës mbi raportimin e dosjeve të dëmit të grupuar sipas statusit për muajin aktual, vitin aktual dhe totalin.

- Kuadri ligjor dhe njoftimet në lidhje me Regjistrin Elektronik të Dëmeve.
- Funksionaliteti për të ndryshuar fjalëkalimin e përdoruesit.

2. NGJARJE E RE

Hierarkia që do të zbatohet në Regjistrin Elektronik të Dëmeve, do të jetë: **Ngjarje – Dosje Dëmi – Përfitues**.



Një ngjarje do të konsiderohet një ndodhi e aksidentit, në të cilën janë përfshirë një ose më shumë dosje dëmi. Një dosje dëmi do të ketë vetëm një përfitues. Pavarësisht përfituesve, secili prej tyre mund të ketë dëme të kategorive të ndryshme (Shëndetësor, Material; Biologjik, Moral dhe Ekzistencial).

Në menunë NGJARJA E RE kemi:

- **Të dhënat e aksidentit:**
  - **Fond Kompensimi -** (PO/JO) – Është me mundësi përzgjedhjeje, nëse ngjarja do të jetë Fond Kompensimi ose jo;
  - **Kodi i dëmit Shoqëri -** (alfa numerike) – Është kodi unik i ngjarjes, e cila plotësohet nga shoqëria e sigurimit ose BSHS;

- **Datë aksidenti -** (datë dd/mm/yyyy) – Është data ndodhjes së aksidentit, e cila nuk mund të jetë me e vonshme se data e sotme;
- **Data e raportimit të ngjarjes -** (datë dd/mm/yyyy) - Është data e raportimit, e cila nuk mund të jetë më e hershme se data e aksidentit dhe më e vonshme se data e sotme;
- **Vendngjarja -** Është e dhënë, e cila plotësohet me bashkitë në të cilën ka ndodhur aksidenti;
- **Rajoni i policisë -** Njësia e policisë përgjegjëse të bashkisë ku ka ndodhur aksidenti;
- **Nr. i Raportit të Policisë -** Nr. i proces verbalit të policisë për ngjarjen e ndodhur;
- **Shënime -** Hapësirë për komente te ndryshme rreth ngjarjes.

- **Të dhënat e shkaktarit**
  - **Identifikuar** (PO/JO) - Nqs shkaktari është i paidentifikuar do të përzgjidhet JO. Gjeneralitetet, të dhënat e policës, apo të mjetit dëmtues, regjistri i dëmeve automatikisht e çaktivizon mundësinë për plotësim. Në këtë rast, ngjarja mund të shpëtohet.



Nqs shkaktari është i identifikuar do të përzgjedhim PO dhe do të procedojmë në fushën pasardhëse.

  - **Mjet i Siguruar** (PO/JO) - Nqs shkaktari është i identifikuar por i pa siguruar, do të përzgjidhet JO. Për këtë rast të dhënat e gjeneraliteteve dhe mjetit dëmtues të shkaktarit do të plotësohen manualisht nga përdoruesi.
    KUJDES: Për gjeneralitetet e shkaktarit për rastet e TPL, të dhënat duhet do të plotësohen saktë, pasi konsultohen në kohë reale me Regjistrin e Gjendjes Civile.
    Ndërsa për të dhënat e policës, regjistri i dëmeve automatikisht e çaktivizon mundësinë për plotësim.
    Pas plotësimit sipas kritereve të mësipërme, ngjarja mund të shpëtohet.



Nqs shkaktari është i identifikuar dhe i siguruar do të përzgjidhet PO dhe do të procedohet me plotësimin e kodit të policës si më poshtë sqaruar.

- **Kodi i policës AMF** (alfanumerik, 15 shifrat e fundit) – Nqs shkaktari është i identifikuar dhe i siguruar, do të procedohet me plotësimin e kodit të policës. Nga plotësimi i kodit 15 shifror të policës, do të përzgjidhet shkaktari, që është shënuar në policë (Pronar/Përdorues) apo Tjetër. Tjetër nënkupton kur nuk është shënuar në policë.

  KUJDES: Polica duhet të jetë e raportuar në Regjistrin Elektronik Online të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik (AMF), të ketë qenë në statusin aktiv (Shitur, Dublikatë) dhe data e aksidentit duhet të ketë qenë brenda periudhës së mbulimit të policës.

  Në rast se shkaktari i përzgjedhur është pronar/përdorues i shënuar në policë, Regjistri i Dëmeve konsultohet me Regjistrin Elektronik Online të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik (AMF) dhe plotëson automatikisht të dhënat e gjeneralitetet, e policës dhe automjetit dëmtues.

Gjithsesi të dhënat e mara nga Regjistri Elektronik Online i Sigurimit të Detyrueshëm Motorik (AMF), Emër, Mbiemër dhe ID, janë me mundësi ndryshimi që të përputhen me të dhënat e Gjendjes Civile.



Në rast se shkaktari i përzgjedhur është tjetër (jo shënuar në policë), Regjistri i Dëmeve konsultohet me Regjistrin Elektronik Online të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik (AMF) dhe plotëson automatikisht vetëm të dhënat e policës dhe mjetit dëmtues, ndërsa gjeneralitetet do të plotësohen manualisht nga përdoruesi.



KUJDES: Për secilin nga rastet e mësipërme të dhënat, gjeneralitetet e shkaktarit, do të konsultohen në kohë reale me Regjistrin e Gjendjes Civile.

- **Gjeneralitetet e shkaktarit**
  - **Tipi i shkaktarit** (individ/subjekt) – Mundësi përzgjedhjeje sipas rastit
  - **Emër**
  - **Mbiemër**
  - **Atësia**
  - **Gjinia**
  - **Datëlindja** (date dd/mm/yyyy)
  - **ID/NIPT** (alfanumerik, 10 karaktere) – Nr. Personal nqs tipi i klientit është Individ dhe NIPT-i nqs tipi i klientit është subjekt.
  - **Profesioni** (Student, i Punësuar, i Papunë, në Pension) - Mundësi përzgjedhjeje manuale nga përdoruesi sipas rastit.
  - **Dëshmia e aftësisë** - Numri identifikues i dëshmisë së aftësisë së shkaktarit, i cili plotësohet manualisht nga përdoruesi.
  - **Data e lëshimit** – Data e lëshimit të dëshmisë së aftësisë, e cila plotësohet manualisht nga përdoruesi.
- **Të dhënat e policës**
  - **Lloji i Policës** (TPL, Karton Jeshil, Policë Kufitare)
  - **Nr. Serisë** policës
  - **Data e fillimit** (datë dd/mm/yyyy) – Data e fillimit të vlefshmërisë së policës
  - **Data e mbarimit** (datë dd/mm/yyyy) – Data e mbarimit të vlefshmërisë së policës

- **Të dhënat e automjetit dëmtues**
  - **Targa**
  - **Shasia**
  - **Marka**
  - **Modeli**
  - **Viti i prodhimit**
  - **Fuqia motorike**
  - **Kategoria/Klasa**
  - **Jashtë përdorimi** (PO/JO) – Mjetet e dëmtuara rendë gjatë aksidentit
  - **Dëmtime të mjetit** – Nqs Jashtë përdorimi = JO, atëherë duhet të vendoset një shënim në lidhje me dëmtimet e mjetit.

2.1. Dosje e Re

Në momentin e shpëtimit të ngjarjes, siç është përshkruar më sipër, mund të procedohet me shtimin e dosjeve të re duke klikuar në butonin: +SHTO DOSJE DËMI. Në hierarkinë e përdorur një ngjarje mund të ketë disa dosje, e cila nga ana e saj mund të ketë vetëm një përfitues.

Pas shtimit të "Dosjes së Re", në këtë stad, mund te kthehemi përsëri në ngjarjen duke klikuar butonin Shfaq Ngjarjen në rast se ka nevojë për ndryshim.



- **Të dhënat e dosjes**
  - **Kodi i dëmit AMF** (alfanumerik) - Kod unik i gjeneruar nga Regjistri Elektronik i Dëmeve.
  - **Kodi i dosjes shoqëri** (alfanumerik) – Është kodi unik që gjenerohet nga bashkimi i kodit të ngjarjes shoqëruar sipas rregullit: "//1 (për dosjen e parë)", "//2 (për dosjen e dytë)" e kështu me radhë.
  - **Datë raportimi** (datë dd/mm/yyyy) – Data e raportimit të dosjes, e cila nuk mund të jetë më e hershme se data e raportimit të ngjarjes dhe më e vonshme se data aktuale.
  - **Dokumentacion i plotësuar** (PO/JO) – Është e dhëna e cila plotësohet me PO në momentin kur i gjithë dokumentacioni nevojshëm për ngjarjen është i kompletuar. **KUJDES! Duhet të bëhet shumë kujdes me plotësimin e kësaj date, pasi është kjo datë që do të shërbejë për afatet e trajtimit të dosjeve.**

- **Data e plotësimit të dokumentacionit** (datë dd/mm/yyyy) – Është data e cila plotësohet në momentin e kompletimit të dokumentacionit për ngjarjen, e cila nuk mund të jetë më e hershme se data e raportimit të ngjarjes dhe më e vonshme se data e sotme.

- **Statusi i dosjes:**

  Statuset e Dëmit për shoqëritë: Në Trajtim**,** Miratuar pa Paguar**,** I Refuzuar**,** I Paguar**,** I Paguar Pjesërisht, Në Proces Gjyqësor SHKI, Dërguar Shoqërisë Identifikuar, Për Rimbursim nga Shoqëria Identifikuar, Në Proces Gjyqësor SHK II/Apel, Në Proces Gjyqësor Gjykatë e Lartë, Përmbarimor, Mbyllur.

- **Shoqëria e Sigurimit** - Është opsionale dhe përzgjidhet vetëm për disa nga statuset e caktuara:
  - Dërguar Shoqërisë Identifikuar;
  - Për Rimbursim nga Shoqëria Identifikuar.



- **Statusi MBYLLUR** - do të përzgjidhet për ato dosje, që kanë kaluar afatin e parashkrimit dhe trajtimit të praktikës (në bazë edhe të rregulloreve të miratuara). Në momentin e përzgjedhjes së këtij statusi, dosja duhet të shoqërohet me shënimin rreth arsyes së mbylljes dhe për këtë dosje nuk do të ketë mundësi modifikimi të të dhënave të saj.

- **Data njoftimit të përfituesit për plotësimin e dokumentacionit** - Në rastet kur kërkesa e paraqitur nuk është e plotë, shoqëria e sigurimit i drejtohet paraqitësit të kërkesës me shkrim brenda 8 ditëve pas pranimit të kërkesës dhe kërkon plotësimin e dokumentacionit.
- **Detajet e njoftimit të përfituesit për plotësimin e dokumentacionit** – Fushë tekst për te vendosur manualisht numrin e protokollit të kësaj shkrese njoftuese, apo edhe llojin e njoftimit email, sms, etj.
- **Data njoftimit të përfituesit në përfundim të trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim** - Në rast pranimi të kërkesës, shoqëria e sigurimit duhet të njoftojë palën e dëmtuar për masën e dëmshpërblimit të vlerësuar prej saj, ose në rast refuzimi të kërkesës, shoqëria e sigurimit duhet të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar për refuzimin dhe shkaqet ligjore, që çojnë në këtë refuzim. Kjo fushe duhet te shoqërohet edhe me ndryshimin e statusin te dosjes, sipas rastit.
- **Data e nënshkrimit të deklaratës së pranimit të dëmshpërblimit** – Data e cila plotësohet ne rast të pranimit të dëmshpërblimit. Shoqëria e sigurimit do të kryejë pagesën e dëmshpërblimit brenda 14 ditëve pas datës se nënshkrimit të deklaratës së pranimit.

- **Vlerat e dëmit**
  - **Monedha** (LEK/EURO) – mundësi përzgjedhje sipas rastit.
  - **Matrica e vlerave të dëmit** (numerike) – përmban llojet e dëmit Shëndetësor, Material, Biologjik, Moral dhe Ekzistencial (në rreshta) dhe vlerat Përllogaritur, Rivlerësuar, Gjyqësor, Paguar dhe Mbetur për secilin nga llojet e dëmit (në kolona).



KUJDES: Vlerat në kolonën "Përllogaritur" kanë mundësi të plotësohen vetëm një herë. Çdo vlerë tjetër që dosja mund të ketë në rast ndryshimi, do të shkruhet në kolonë "Rivlerësuar".
Në momentin e plotësimit të kolonave: "Përllogaritur", "Rivlerësuar" ose "Gjyqësor", Regjistri i Dëmeve do të llogarisë vlerat në kolonën e cila ka përditësimin më të fundit.

Kolona: “Paguar”, do të përmbajë vlerat e paguara për secilin nga llojet dëmit. Këto vlera do të merren nga funksionaliteti: “Shto Pagesë Dëmi”.
Kolona “Mbetur” do të përmbajë vlerat e mbetura për secilin nga llojet dëmit, si diferencë e vlerës së kolonës me përditësimin më të fundit dhe vlerës së paguar.

Kolona “Gjyqësor” është e çaktivizuar deri në momentin kur një dosje dëmi mund të marrë statusin “Në Proces Gjyqësor” (**pas vendimit të gjykatës**).



- **LLOJI I PAAFTËSISË SHËNDETËSORE** – Ne rast plotësimi të llojit te dëmit shëndetësor, atëherë detyrimisht duhet te shoqërohet me plotësimin e kësaj fushe me një nga opsionet:
  - Pasojë Vdekje;
  - E Përhershme;
  - E Përkohshme.

- **Të dhënat e përfituesit**
  - **Tipi i përfituesit** (Individ/Subjekt) – Mundësi përzgjedhjeje sipas rastit
  - **Emër**
  - **Mbiemër**
  - **Atësia**
  - **Gjinia**
  - **Datëlindja** (datë dd/mm/yyyy)
  - **ID/NIPT** (alfanumerik, 10 karaktere) – Nr. Personal nqs tipi i klientit është Individ dhe NIPT-i nqs tipi i klientit është subjekt.

Të dhënat e përfituesit do të plotësohen manualisht nga përdoruesi i Regjistrit të Dëmeve, por këto të dhëna do të konsultohen me Regjistrin e Gjendjes Civile.

- **Të dhënat e automjetit të dëmtuar**
  - **Mjet i Dëmtuar** (PO/JO) – Nqs përfituesi nuk ka mjet të dëmtuar do të përzgjedhim JO. Nqs përfituesi ka mjet të dëmtuar do të plotësohet me PO dhe do të shoqërohet me të dhënat e mjetit.
  - **Targa** – targa e mjetit të dëmtuar
  - **Shasia** – nr. shasise të mjetit të dëmtuar

- **Jashtë përdorimi (PO/JO)** – Mjetet e dëmtuara rende gjatë aksidentit
- **Dëmtime të mjetit** – Nqs Jashtë përdorimi = JO, atëherë duhet të vendoset një shënim në lidhje me dëmtimet e mjetit.

2.2. Shto Pagesë Dëmi

Në momentin e shpëtimit të dosjes me sukses (sipas mesazhit me ngjyrë jeshile), mund të procedohet me shtimin e pagesës duke klikuar butonin +SHTO PAGESË DËMI.
Në këtë stad, mund të kthehemi përsëri në ngjarjen duke klikuar butonin "Shfaq Ngjarjen" në rast se ka nevojë për ndryshim. Gjithashtu edhe për ndryshimin e dosjes në të cilën ndodhemi.



- **Të dhënat e pagesës**
  - **Të dhënat e përfituesit –** Janë të dhënat që merren për përfituesin dhe automjetin nga dosja e dëmit. Janë pa mundësi ndryshimi, thjesht informuese.

- **Shumat e përfituara**
  - **Totali i përfituar** - Shfaq totalin e vlerës së dëmit të kolonës më të fundit të përditësuar nga dosja e dëmit.
  - **Totali i paguar –** Shfaq totalin e vlerës së dëmit të kolonës "paguar" nga dosja e dëmit.

- **Totali i mbetur –** Shfaq totalin e vlerës së dëmit të kolonës “mbetur” nga dosja e dëmit, e cila llogaritet si diferencë nga totali i përfituar me totalin e paguar.

- **Paguaj**
  - **Dëmi i paguar –** Përzgjedh vlerat e llojit të dëmit, përcaktuar më parë në matricën e vlerave të dëmit.
  - **Data e pagesës –** Data në të cilën paguhet dëmi, e cila nuk mund te jete me e hershme se data e raportimit të dosjes dhe më e vonshme se data e sotme.
  - **Shuma e paguar –** Vlera që do të paguhet për llojin e dëmit, e cila nuk mund jetë më e madhe se vlera e përcaktuar më parë në matricën e vlerave të dëmit.
    KUJDES! Ne baze edhe te rregullores nr. 34, “PËR RAPORTIMIN E DETYRUAR DHE PERIODIK TËSHOQËRIVE TË SIGURIMIT DHE RISIGURIMIT”: Dëme të paguara bruto përfshijnë vlera monetare e kompensimit për dëmin e ndodhur dhe shpenzimet e trajtimit që i përkasin këtyre dëmeve. Vlera e kompensimit për dëmin e ndodhur është shuma që përfitojnë personat e siguruar në rastin e ndodhjes së dëmit, sipas rezultatit të raportit të vlerësimit.
  - **Mënyra e pagesës** – Përzgjedh llojin e pagesës, Cash, Transfertë Bankare, Cek.



Në këtë sesion, mund të aplikohet edhe pagesa e llojit të dëmit me këste duke përzgjedhur Datë Pagese të ndryshme me vlerë të ndryshme.

Në këtë stad, mund të kthehemi përsëri në dosje duke klikuar butonin Shfaq Dosjen në rast se ka nevojë për ndryshim.

Për rastet kur dosja e dëmit, ka të paktën një pagesë, atëherë dosja do të marrë në mënyrë automatike statusin: “I Paguar Pjesërisht”.



Në këtë stad, mund të ndryshojmë të dhënat e dosjes, duke klikuar butonin: “Ndrysho Dosjen”, ose mund të shfaqim ngjarjen duke klikuar butonin: “Shfaq Ngjarjen”.

Për rastet kur dosja e dëmit, vlerën e mbetur e ka zero pra janë kryer të gjitha pagesat, atëherë dosja do të marrë në mënyrë automatike statusin: “I Paguar”.

KUJDES: Dosja në statusin: “I PAGUAR” nuk ka më mundësi ndryshimi të të dhënave të saj.



3. KËRKO NGJARJE

Në menunë kryesore kemi funksionalitetin: "KËRKO NGJARJE" e cila mundëson kërkimin e ngjarjes me kriter:

- Intervalin kohor sipas datës se aksidentit;
- Kodi i Dëmit Shoqëri.



Pas shfaqjes së rezultatit të kërkimit, mund të procedohet me operacione si SHFAQ apo NDRYSHO ngjarjen.

4. KËRKO DOSJE DËMI

Në menunë kryesore kemi funksionalitetin: "KËRKO DOSJE DËMI" e cila mundëson kërkimin e dosjeve me kritere:

- Periudha e Raportimit me (datë fillimi dhe datë mbarimi);
- Kodi i Dosjes AMF;
- Kodi i Dosjes Shoqëri;
- Sipas Statusi;
- Fond Kompensimi.



Pas shfaqjes së rezultatit të kërkimit, mund të procedohet me operacione si SHFAQ apo NDRYSHO dosjen. Gjithashtu ky rezultat mund dhe të eksportohet dhe në formatin excel.

5. KËRKO SHKAKTAR DËMI

Në menunë kryesore kemi funksionalitetin: “KËRKO SHKAKTAR DËMI” e cila mundëson kërkimin e shkaktarit me kriteret si më poshtë:

- Emër/ Mbiemër;
- ID/ NIPT;
- Targa e Mjetit.



Pas shfaqjes së rezultatit të kërkimit, mund të procedohet me operacione si SHFAQ ngjarjen.

6. DOSJE PËR SHQYRTIM

- Një ngjarje raportohet si paralajmërim për shoqërinë ME PROBLEME, kur një shkaktar ka disa ngjarje dëmi, ku të dhënat KODI POLICËS AMF, EMER, MBIEMER dhe NR. PERSONAL janë të njëjta, brenda një intervali 30-ditor të datës së raportimi të ngjarjes. Në ketë shkaktari do të këtë gjendje POTENCIAL PER FRAUD.

- Një ngjarje raportohet si paralajmërim për shoqërinë ME PROBLEME, kur dy dosje brenda një shoqërie kanë përfitues të njëjtë, ku të dhënat: KODI POLICES AMF, TARGË, NR_PERSONAL janë të njëjta, brenda intervalit 7-ditor të datës së aksidentit. Në këtë rast dosja do të ketë gjendjen DOSJE DYSHIMTE.

7. KËRKO PËRFITUES

Në menunë kryesore kemi funksionalitetin: “KËRKO PËRFITUES”, e cila bën të mundur kërkimin mbi përfituesin sipas të dhënës së nr. të shasisë dhe datës së aksidentit, nqs është trajtuar nga ndonjë shoqëri tjetër për te shmangur raste e abuzimeve, qe te përfitojnë dëmshpërblim edhe nga sigurime te tjera si KASKO.



Ne rast se gjen rezultat si figura e mësipërme.



Ne rast se nuk gjen rezultat si figura e mësipërme.

8. KËRKO DOSJE TË PAGUARA

Në menunë kryesore kemi funksionalitetin: “KËRKO DOSJE TË PAGUARA” e cila mundëson kërkimin e dosjeve te paguara sipas datës së raportimit të dosjes (periudhë) ose me date pagese (periudhë) me kriteret:

- DATË REGJISTRIMI DOSJE FILLIM;
- DATË REGJISTRIMI DOSJE MBARIM;
- DATË PAGESE FILLIM;
- DATË PAGESE MBARIM.



Rezultati i këtyre kërkimeve mund të eksportohet ne Excel për përpunime nga ana juaj.

ANEKSI 2

Integrimi i Regjistrit të Dëmeve me sisteme të tjera

PËRMBAJTJA

PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM 30

ENTITETET QË SISTEMET KLIENTE MUND TË MARRIN NGA WEBSERVICE 30

ENTITETET QË SISTEMET KLIENTE MUND TË DËRGOJNË DREJT WEBSERVICE 31

INTEGRIMI ME SISTEME TË TJERA 33

TEKNOLOGJIA E PËRDORUR 33

IDENTIFIKIMI & AUTORIZIMI 33

PËRGJIGJET E WEBSERVICE & MESAZHET E GABIMIT 37

ENTITETET QË SISTEMET KLIENTE MUND TË MARRIN NGA WEBSERVICE 38

ENTITETET QË SISTEMET KLIENTE MUND TË DËRGOJNË DREJT WEBSERVICE 31

PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM

Regjistri i Dëmeve është pjesë e Qendrës së Raportimit Online. Dëmet e ndodhura në kuadër të sigurimeve të detyrueshme motorike raportohen online në Regjistrin e Dëmeve nga Shoqëritë e Sigurimeve.

Në Regjistrin Eletronik të Dëmeve, të dhënat plotësohen nga shoqëritë nëpërmjet një ndërfaqe me lehtësi dhe siguri aksesimi e përdorimi. Dëmet identifikohen në mënyrë unike në bazën e të dhënave dhe çdo informacion tjetër i lidhur me to.

Qëllimi i ketij dokumenti është pershkrimi i integrimit të Regjistrit me sisteme të tjera raportimi.

Për këtë synohet ndërtimi i një **Webservice RESTful** i cili do të ofrojë të gjitha funksionalitetet në dispozicion në aplikacionin web eksistues.

Me anë të integrimit:

1. Sistemet kliente mund të marrin të dhëna nga webservice sipas kërkesës;
2. Sistemet kliente mund të dërgojnë të dhëna drejt webservice.

ENTITETET QË SISTEMET KLIENTE MUND TË MARRIN NGA WEBSERVICE

1. Lista e bashkive;
2. Lista e rajoneve të policisë;
3. Lista e llojeve të policës;
4. Lista e llojeve të dëmit të shkaktuar;
5. Lista e statuseve të dëmit;
6. Lista e shoqërive të sigurimit;
7. Lista e ngjarjeve të shoqërisë, të gjetura sipas kritereve të kërkimit;
8. Lista e dosjeve të dëmeve të shoqërisë, të gjetura sipas kritereve të kërkimit;
9. Lista e shkaktarëve të dëmeve të shoqërisë, të gjetur sipas kritereve të kërkimit;
10. Lista e dosjeve të dëmeve të shoqërisë për shqyrtim;
11. Informacioni mbi përfituesin e gjetur sipas kritereve të kërkimit, për të shmangur rastet e Fraud;
12. Lista e dosjeve të paguara të shoqërisë, të gjetura sipas kritereve të kërkimit;
13. Ngjarja e shoqërisë, e identifikuar nga ID e ngjarjes;
14. Informacionet bazë të ngjarjes së shoqërisë, e identifikuar nga ID e ngjarjes;
15. Shkaktari i ngjarjes së shoqërisë, e identifikuar nga ID e ngjarjes;
16. Lista e dosjeve të dëmit të ngjarjes së shoqërisë, e identifikuar nga ID e ngjarjes;

17. Dosja e dëmit e shoqërisë, e identifikuar nga ID e dosjes;
18. Informacionet bazë të dosjes së dëmit të shoqërisë, e identifikuar nga ID e dosjes;
19. Lista e vlerave të dëmit të dosjes së shoqërisë, e identifikuar nga ID e dosjes;
20. Lista e pagesave të dosjes së dëmit të shoqërisë, e identifikuar nga ID e dosjes;
21. Përmbledhja e gjendjes së dosjeve të dëmeve të shoqërisë;
22. Lista e artikujve të kuadrit ligjor;
23. Lista e artikujve të njoftimeve nga AMF;
24. Informacionet e aksesit të përdoruesit.

ENTITETET QË SISTEMET KLIENTE MUND TË DËRGOJNË DREJT WEBSERVICE

1. Ngjarje e re;
2. Dosje e re në një ngjarje ekzistuese të shoqërisë, e identifikuar nga ID e ngjarjes;
3. Pagesë e re për një vlerë dëmi të dosjes së shoqërisë, e identifikuar nga ID e vlerës dëmit;
4. Përditësimi i të dhënave të një ngjarje ekzistuese të shoqërisë, e identifikuar nga ID e ngjarjes;
5. Përditësimi i të dhënave bazë të një ngjarje ekzistuese të shoqërisë, e identifikuar nga ID e ngjarjes;
6. Përditësimi i të dhënave të shkaktarit të një ngjarje ekzistuese të shoqërisë, e identifikuar nga ID e ngjarjes;
7. Përditësimi i të dhënave të një dosje ekzistuese të shoqërisë, e identifikuar nga ID e dosjes;
8. Përditësimi i të dhënave bazë të një dosje ekzistuese të shoqërisë, e identifikuar nga ID e dosjes;
9. Përditësimi i vlerave të dëmit të një dosje ekzistuese të shoqërisë, e identifikuar nga ID e vlerës dëmit;
10. Fshirje pagese dëmi të një dosje ekzistuese të shoqërisë, e identifikuar nga ID e pagesës;

Në këtë dokument do të paraqitet teknologjia e përdorur, mënyra se si bëhet shkëmbimi i të dhënave, konfigurimet e nevojshme që duhen kryer për integrimin, shpjegime për entitetet, etj.

INTEGRIMI ME SISTEME TË TJERA

TEKNOLOGJIA E PËRDORUR

Webservice i Regjistrit të Dëmeve do të zbatohet duke u bazuar në konceptin e **RESTful API** e cila lejon një shkallë të lartë fleksibiliteti.

Natyra **stateless** e teknologjisë mundëson përshkallëzim të resurseve duke instaluar disa instanca të webservice pas një **load-balancer** në rastet kur numri i kërkesave nga aplikacionet *kliente* është i lartë.

Webservice do jetë në dëgjim në adresën: ***https://claims-ws.amf.gov.al:30433/api/v1***

IDENTIFIKIMI & AUTORIZIMI

Procesi i identifikimit të sistemeve të tjera për përdorimin e API do të ndjekë të njëjtat hapa që ndjek edhe identifikimi i përdoruesve në aplikacionin web ekzistues të Regjistrit të Dëmeve.
Përdoruesit e Regjistrit të Dëmeve janë të pajisur me kredencialet e aksesit të cilat përbëhen nga: përdorues (***username***), fjalëkalim (***password***) dhe token që është një vektor (array) me 11 elemente alfanumerike.

1. Sistemi klient do fillojë procesin e identifikimit duke:
   a. Dërgon një kërkesë ***GET*** në adresën ***https://claims-ws.amf.gov.al:30433/api/v1/login/init***;
   b. API përgjigjet në formatin ***JSON*** duke dërguar një string random sëbashku me indekset e elementeve të token të përdoruesit që do duhet të përdoren gjatë procesit të identifikimit.

```
{
    "random": "asdf1234567",
    "tokens": [ 1, 3, 7, 11 ]
}
```

Fig. 1 *Shembull përgjigje ne nga API GET https://claims-ws.amf.gov.al:30433/api/v1/login/init*

   Vlefshmëria e string-ës random dhe elementeve token është e paracaktuar në ***3 minuta*** nga momenti i krijimit. Në rast vonesash gjatë procesit të identifikimit, përtej afatit të paracaktuar, webservice dërgon një përgjigje ***HTTP*** *me status code* ***401 (Unauthorized)*** dhe do duhet që sistemi klient të rifillojë procesin e identifikimit nga e para (pika a.).

2. Sistemi klient do të identifikohet në webservice duke:
   a) Dërgon një kërkesë ***POST*** në adresën ***https://claims-ws.amf.gov.al:30433/api/v1/login***, ku *Content-Type* e kërkesës është e tipit *application/json* dhe trupi i kërkesës përmban

parametrat: ***random*** (i cili është një string e njëjtë me vlerën e marrë gjatë hapit 1), ***username*** (e cila është një string dhe ka vlerë të njëjtë me username-in e përdoruesit që po tenton të logohet) dhe ***hashed*** është një string e cila ka vlerë:

hashed = MD5(random + username.UPPERCASE + MD5(password) + token[1] + token[3] + token[7] + token[11])

Në algoritmin e mësipërm duhet të bëhet kujdes që simboli **+** nënkupton ***string concatenation*** dhe përdoren ato elemente të token të përdoruesit siç i ka kërkuar webservice, në këtë rast elementet në pozicionet 1, 3, 7 dhe 11 të vektorit (array).

Shembull:

Në rast se krendecialet e përdoruesit janë:

Username: përdoruesi

Password: somepasswd

Token: [A, 3, 7 , 2, 8, 1, 9, 0, C, Y, Q]

hashed = MD5(asdf1234567 + PERDORUESI + MD5(somepasswd) + A + 7 + 9 + Q)



Fig. 2 *Shembull Request Header*



Fig. 3 *Shembull parametrash që dërgohen gjatë procesit të identifikimit*

b) Webservice verifikon kredencialet e nisura nga sistemi klient. Në rast se kredencialet nuk janë të sakta, dërgon një përgjigje ***HTTP*** *me status code* ***401 (Unauthorized)***, në këtë rast sistemi klient do duhet të fillojë procesin e identifikimit nga e para.
Nëse kredencialet e aksesit janë të sakta webservice i përgjigjet klientit në formatin JSON dhe i dërgon ***token-in e autorizimit*** të cilin sistemi klient do duhet ta përdorë gjatë gjithë kërkesave të tjera që do dërgojë drejt webservice.

```
{
    "authorization_token": "eyJhbGciOiJIUzI1NiIsInR5cCI6IkpXVCJ9
        .eyJzdWIiOiIxMjM0NTY3ODkwIiwibmFtZSI6IkpvaG4gRG9lIiwiaWF0IjoxNTE2MjM5MDIyfQ
        .SflKxwRJSMeKKF2QT4fwpMeJf36POk6yJV_adQssw5c"
}
```


